



THEMELUES I FESTIVALIT: **JUSUF BESHIRI**

Vox Baroque

Festivali i muzikës së vjetër
Edicioni i 4^t

2 - 11 korrik 2017

PROGRAMI

SPONSORËT



BASHKIA TIRANË



BASHKIA KORÇË



BASHKIA SHKODËR



TEATRO KOMUNITARI I
OPERAS
BALETIT



Kalendari i Festivalit

DATA	QYTETI	VENDI	ORA	GRUPI PERFORMUES
2 Korrik 2017	Shkodër	Kalaja e Rozafës	20:00	Sonatas & Canzonas
3 Korrik 2017	Tiranë	Reja e Fujimotos	21:00	Sonatas & Canzonas
4 Korrik 2017	Tiranë	Teatri i Kukullave	20:00	Collegium Pro Musica
6 Korrik 2017	Korçë	Dyqani i Rakos	19:00	Collegium Pro Musica
8 Korrik 2017	Vlorë	Petrolifera Italo-Albanese	20:00	Festa Rustica
9 Korrik 2017	Berat	Muzeu Onufri	19:30	Festa Rustica
11 Korrik 2017	Tiranë	Galeria Kombëtare e Arteve	20:00	Festa Rustica

“Vox Baroque”

(2 deri më 11 korrik, 2016)

Festivali i Muzikës së vjetër “Vox Baroque” mbetet aktiviteti i vetëm në llojin e tij në Shqipëri. Ky festival i kushtohet tërësisht repertorit barok. Përhapja e kësaj muzike të luajtur me instrumente origjinale, në respekt të plotë të stilit, rregullave dhe mënyrës së interpretimit të asaj kohe, shikimi i muzikës me një këndvështrim tjetër historik dhe kritik duke kërkuar gjithmonë qasje të reja, formësojnë idealin tonë për të zhvilluar këtë festival të përvitshëm. Të vetëdijshëm në kurimin e detajeve të repertorit të mirë përzgjedhur, dëshirojmë të kërkojmë më thellë në muzikë drejt rrugës së perfeksionimit të vazhdueshëm, në kërkim të emocioneve dhe esencës të së bukurës. Repertori barok ende sot ofron shumë hapësira për zbulime e thellime, të cilat do të manifestohen nga interpretuesit midis të tjerash mes shëmbujve të gjuhës e gjestualitetit barok. Interpretimi përmes një “assieme” të gjeveve ekspresive të cilat përdoren nga kënetarët për të nënvizuar emocionet e teksteve të kantatave, do të na afrojë drejt atmosferës të skenave operistike.

Në vitet 700 muzika hyn thellë në çdo shtresë të shoqërisë si kurrë më parë duke shënuar kështu emancipimin estetik, artistik e social të muzikës instrumentale. Në këtë proces sheh të afirmuar kompozitorë Italian si Vivaldi, Scarlatti, Sammartini, ku kompozimet e tyre janë të pavarura nga këndvështrimi estetik, koherenca në formën muzikore e në të njëjtën kohë tepër të artikuluar. Këto elementë luajnë një rol vendimtar përkrah kompozitorëve të tjerë si Bach, Haendel dhe Telemann, duke përcjellë një trashëgimi dhe traditë të shkëlqyer në skenat ndërkombëtare. Ndaj dhe në këtë edicion të festivalit është menduar që një hapësirë e veçantë ti dedikohet kompozitorëve Italian dhe në veçanti atyre napoletan. Napoli është qytet që spikat në atë kohë për formimin e shumë kompozitorëve e këngëtarëve (XVII dhe XVIII) dhe kjo falë katër konservatoreve që ky qytet kishte. Në të njëjtën kohë Napoli shquhet për këngën popullore e cila kishte një prezencë të fortë dhe kjo vihet re dhe në artin figurativ të asaj kohe. Shihet qartë që muzika luhej në rrugë ku përdorim të gjerë kishin instrumentet “a pizzico”. Tarantella që një nga format muzikore më të dashura popullore ku bashkohej kantoja dhe vallja. Këtë muzikë të mrekullueshme do e sjellin në këtë festival grupet e njohura si: *Collegium Pro Musica*, *Festa Rustica* dhe *trio Sonatas & Canzonas*. Hapja e festivalit këtë vit do të zhvillohet në Kalanë e Rozafës në Shkodër. Kryeqyteti do të presë muzikantët në tre data dhe ambiente të ndryshme si *Reja* e *Foujimos*, *Teatri* i *Kukullave* dhe *Galeria Kombëtare* e *Arteve*. *Petrolifera Italo-Shqiptare* do të jetë shtëpia e muzikës për një prej koncerteve të festivalit. Korça gjithashtu do të jetë një destinacion tjetër i rrugëtimit të këtij festivali sëbashku me Beratin në hapësirat e Muzeut Onufri.

Një itinerar muzikor dhe turistik për të gjithë ata që dëshirojnë të shijojnë tingujt e kësaj muzike sëbashku me bukuritë e vendeve ku kjo do të luhet, duke promovuar vlerat e trashëgimisë kulturore të vendit tonë.

Jusuf Beshiri

Themelues i Festivalit Ndërkombëtar “Vox Baroque”

Scarlatti e le Canzoni Napoletane

SONATAS E CANZONAS

Enrica Mari
SOPRANO

Jusuf Beshiri
CEMBALO

Arber Cerri
KITARË



Domenico Scarlatti (Napoli, 1685-Madrid, 1757) është një kompozitor të cilit i njohim mirë fazat e tij të formimit muzikor falë dhe babait të tij Alessandro i cili qe po ashtu një kompozitor shumë i njohur i kohës që shquhej për një cilësi të lartë artistike. Djali i tij Domenico krijon në periudhën e pjekurisë së tij “corpus” më mahnitëse të literaturës klavijembalistike, ku karakteristikat në formë, ekspresivitet dhe stil janë të atilla që e bejnë atë unik në panoramën muzikore të epokës. Ai shkruan jo pak por mbi 550 sonata për klavijembal.

Në fakt formimi italian , napoletan në veçanti shihet qartë mbi të gjitha në sonatat e periudhës së parë të krijimtarisë ku veçojmë “*Tempi di Danza*”(giga-tarantella ,allemande alla italiana, gavotte), sonatat “*galante*”, tokatat brilante etj. Pasioni i kompozitorit për ritmin 6/8 ose 12/8, si në sonatat K.103, K.214, K.153, K.214, disonanca dhe melodia me motive popullore Napoletane, hedhur në tastierën e klavijembalit, lind sigurisht në periudhën e rinisë së tij në qytetin e lindjes. Harmonia e sonatave është e thjeshtë dhe përdor përsëritje të shkurtër të skemave harmonike. Këto përsëritje që janë tipike në muzikën popullore të Italisë së jugut, krijojnë një efekt obsesiv që Scarlatti e tregon në muzikën e tij në mënyrë gjeniale, duke e futur në gjuhën muzikore më të lartë të kohës. Në këto sonata-tarantella duket qartë elementi retorik nëpërmjet alterimeve nga maxhor në minor; intervaleve kromatike dhe shpesh kadencave të mbyllura me pasazhe të rrëmbyeshme aq sa dhe elegante.

Ariet Napoletane janë melodi të shkruara në dialekt popullor dhe kanë një origjinë historike vërtet shumë antike. Gjeneza i atribuohet traditës së këngës popullore (*villanelle*) zhvilluar në qytetin e Napolit i cili për shekuj qe një qendër muzikore e kulturore nga më të rëndësishmet në botë. Një tjetër burim mund të konsiderohet Opera Buffa që ishte një zhanër shumë i perhapur në 1700 ku u dalluan shumë

kompozitorë të rendësishëm të epokës Pergolesi, Domenico Scarlatti, Jommelli, Piccini dhe Paisiello. Në tekstet e këtyre operave shihet shkrimi në dialekt napoletan dhe ariet shpesh mbijetonin falë popullit i cili i përvetësonte këto duke i transformuar në *Canzoni dhe Villanelle*.

Në 1800 këto melodi strasformohen në *Arie da Camera* të vërteta kompozuar nga mjeshtër të mëdhenj italian si Bellini, Mercadante, Donizzetti Dhe Tosti. Në 1900 ariet napoletane transformohen në këngë folklorike e të lehta. Disa prej tyre qenë të njohura në të gjithë botën duke u bërë simbol i traditës popullore italiane.

Aria **“Fenesta Vascia”**, këngë antike e 1500 anonime, është e shkruar fillimisht për *calascione* (një tip liuto) e më vonë për mandolinë. Teksti përshkruan dashurinë pa shpresë të një të riu për një vajzë e cila jeton prapa një dritare që do të ishte gjithmonë e mbyllur!

“Michelema” (Michela Mia) është një tarantelë anonime e njohur; kompozuar në 1600. Aria është shkruar gjatë pushtimit turk në Napoli dhe flet për një vajzë (Michela) lindur në mes të detit. Në të vërtetë Michelema përfaqëson simbolikisht ishullin e *Ischias* pranë gjirit të Napolit që turqit e admironin! **“Sciore d’Amenta”** (Lule Mentja), një këngë popullore e 1600, vjen e luajtur gjatë një feste të njohur dhe antike pagane me karroca, maska e fishezkare që mbahet çdo 8 shtator në Napoli prej disa shekujsh.

“La Nova Gelosia” (La nuova Persiana) është një arie anonime e vitit 1700 e quajtur ndryshe dhe *Canzone di Afragòla* (fshat pranë Napolit) në formën e serenatës dedikuar një vajze. La Gelosia është një lloj grile e ngjashme me ato të stilit persian, ku prapa saj qëndron vajza së cilës djaloshi i dashuruar i këndon serenatën **“Chi disse ca la Femmena”** (Chi disse che la Femmina) është një arie e kompozuar nga muzikanti i shquar G.B.Pergolesi për operan *“Lo Frate ‘Nnamurato”* e vitit 1732. Muzika mbart elemente popullore të traditës napoletane ndërkohë që teksti mbetet mjaft original për kohën duke qënë se analizon karakteristikat e grave duke theksuar që këto të fundit njohin më shumë se sa vetë djalli.

“Lu Cardillo” (Il Cardellino) është një arie dhe kjo e 1700 me vargje sugjestionuese që shprehin vuajtjet e një dashurie të pamundur. Mesazhi i kësaj arie është që dashuria shpesh ndjell xhelozin Il senso dell’aria è che l’amore rende irragionevoli e gelosi.

“La Fata dello Scodillo” (La fata dello Scudillo) është një tjetër arie struktura muzikore e së cilës evokon kompozime të tjera si : *una Canzona* e 1500 shkruar nga Leonardo da Vinci; *Sonata VIII* op.5 për violinë dhe basso continuo e Corellit; *Sonata I* op.2 për violinë dhe basso continuo e Vivaldit; një arie nga opera Mosè e Rossinit. **“Lu Ciuccio de Cola”** (L’asino di Nicola). Këngë popullore e 1700, e risjellë muzikalisht nga kompozitori Luigi Biscardi në 1800. Anonimo del 1600 Sciore d’Amenta.

Programmi:

D. Scarlatti (1685-1757)
Sonata K159 në do maxhor

D. Scarlatti (1685-1757)
Sonata K214 në re maxhor

Anonimo (1600)
Michelemmà

D. Scarlatti (1685-1757)
Sonata K176 në re minor

Anonimo (1600)
Sciore d'Amenta

D. Scarlatti (1685-1757)
Sonata K174 në do minor

Anonimo (1700)
La Nova Gelosia

D. Scarlatti (1685-1757)
Sonata K9 në re minor

G. B. Pergolesi (1710-1736)
Chi disse ca la Femmena

D. Scarlatti (1685-1757)
Sonata K153 në sol maxhor

Anonimo (1700)
Lu Cardillo

D. Scarlatti (1685-1757)
Sonata K103 në sol maxhor

Anonimo (1700)
La Fata dello Scodillo

D. Scarlatti (1685-1757)
Sonata K 181 në la maxhor

Anonimo (1700)
Lu Ciuccio de Cola

Artistët

ENRICA MARI

SOPRANO

(Sonatas e Canzonas)



Enrica Mari, ka nisur studimet e saj muzikore në instrumentin e violines në Napoli e më pas është diplomuar në konservatorin Santa Cecilia në Romë. Aktualisht është pedagoge violine në konservatorin e Latinës. Ajo gjithashtu është diplomuar në kanto me notë maksimale dhe lodum nën udheheqjen e nënës së saj Dora Liguori dhe të prof. Talone. Është perfeksionuar në Gjermani, Spanjë, si dhe pranë Mozarteum në Salsburg. Për muzikën baroke ka ndjekur kursin e Urbinos me A. Mellon e C. Miatello. Ka debutuar në "Campanella" e Donizzetti në teatrin "VALLE" të Romës e më pas ka interpretuar si disa role kryesore operistike në shumë teatro e salla te rendesishme si ajo e Concertgeboë në Amstërdam Teatro San Carlo në Napoli etj. Ka fituar konkursin internacional "S. Mercadante", "Bonporti". Enrica Mari ka regjistruar CD të ndryshme me muzikë baroke me ansamblin "Festa Rustica" për shtëpinë diskografike AGORA, Kantatat Napoletane te shtatëqindës për revisten ORFEO.

Aktiviteti i saj koncertal ka qënë shumë i ngjeshur; mjafton të përmendim disa prej festivaleve si "Sagra Musicale Umbra", Cappella della Pieta dei Turchini" në Napoli, "La Serva Padrona" në festivalin " BeMus" të Beogradit, " Les Journees du Patrimoine Europeennes" të Francës, Lugano, Montecarlo (Theatre Michel Daner), Festivali i Due Mondi i Spoletos, në Milano, Teatro dal Verme me orkestrën Guido Cantelli, Rumani me orkesrën sinfonike të Timishoarës. Po kështu veçojmë disa recitale në Madrid dhe Maltë.

Ka mbajtur disa masterklase në konservatorin superior të Granada dhe Malaga (Spanjë), në universitetin e Szeged (Hungari) dhe atë te Bursës ne Turqi. Në 2013 ka marrë cmimin special të karrieres "Albatros".

JUSUF BESHIRI

CEMBALO

(Sonatas e Canzonas)



Jusuf Beshiri nis fillimet e studimeve ne piano në moshën 6 vjeç dhe në 1989 diplomohet në Istitutin e lartë të arteve (sot UART) me vlerësimin maksimal të pikeve. Në 1991 transferohet në Milano duke filluar studimet në specialitetin “Organo dhe kompozicion organistik” pranë Konservatorit Giuseppe Verdi – Milano. I përfundon studimet me vlerësimin maksimal ne vitin 1998. Pas përfundimit te ketyre studimeve frekuenton kurse perfeksionimi per repertorin organistik pranë prof. Michael Radulescu ne Liechtenstein, me Luigi Tagliavini dhe Jose Uriol pranë Akademisë së muzikës organistike në Pistoia. Ndërkohë bëhet pjesëmarres në shumë aktivitete artistike në mjaft qytete italiane si dhe jashtë saj, si Zvicër, Francë, Belgjikë, Slloveni, Shqipëri etj. Ndërkohë fillon studimet pranë “Accademia Internazionale della Musica” seksioni i muzikës antike -Milano për klavicembal në klasën e Laura Alvini, per ti përfunduar në Konservatorin e Milanos ne 2001 në specialitetin e instrumentave të vjetër si klavikordo, klavicembalo dhe fortepiano. Vlerësimi maksimal në diplomë dhe në këto instrumente bëri qe aktiviteti i tij artistik në itali të jetë tepër aktiv dhe i vlerësuar nga kritika e kohes. Ndërkohë fiton dhe konukrsin internacional të klavicembalit G:CAMBI në qytetin e Pesaros (Itali).

Nga 2000-2011 bën pjesë në “UNITED EUROPE CHAMBER ORCHESTRA” si klavicembalist, organist dhe fortepianist duke zhvilluar një aktivitet të madh koncertal në repertorin barok dhe muzikes “sacra”. Regjistron disqe për RCA, ITALIAN ÈAY MUSIC, VIDEO RHONA CLASIC. Perveç pjesëmarrjes në këtë orkestër, është aktiv dhe në formacione të ndryshme të muzikës së dhomës duke bashkëpunuar me “Pomeriggi Musicali”, orchestra “Guido Cantelli”, Brianza Classica, “Festival Adriatico Mediterraneo” si dhe në Shqipëri si i ftuar nderi me “Mozaik”, “Kamerata e Tiranës”, “Festival internazionale NEI SUONI DEI LUOGHI” “Takimet muzikore të dy boteve”, Stina koncertore në Universitetin e Arteve. Orkestra e Radiotelevizionit Shqiptar. Gjithashtu ka qenë organisti dhe klavicembalisti i parë i cili ka luajtur në inaugurimin e katedrales së Shen Palit ne Tiranë, i cili u organizua dhe me prezencen e Sekretarit te Vatikanit , Kardinal Sodano. Eshte i ftuar i pervitshëm në festivalin internacional organistik

“Città di Arezzo”. Aktivitetit artistik i është bashkangjitur dhe ai didaktik. Ky i fundit fillon menjehere pas studimeve në Milano duke dhënë mësim si docent në “Accademia Internazionale della Musica” nga 2003-2010.

Eksperiencën e tij shume vjeçare në fushën e muzikës antike dhe baroke si dhe didaktike e sjell per herë të parë në Shqipëri me ftesë nga UART dhe mbështetje nga programi Brain Gain (UNDP) duke hapur për herë të parë katedrën e instrumentit të klavicembalit dhe muzikës baroke në vendin tonë.

Aktualisht zhvillon aktivitetet koncertale dhe didaktike mes Italisë dhe vendit të lindjes. Pasioni për të shtrirë kulturën baroke në Shqipëri si dhe dëshira për të promovuar trashëgiminë kulturore vendase e bëjnë që të ideoi dhe themeloi festivalin ndërkombëtar Vox Baroque, unik në llojin e tij, ku tingujt barok mund të vlerësohen brenda hapësirave të kishave, amfiteatrove a rrënojave arkeologjike.

ARBER CERRI

KITARË

(Sonatas e Canzonas)



Arber Cerri nisi studimet e kitarës në moshën shtatë vjeçare duke vazhduar studimet ne Elbasan. Në 2007 ai nisi studimet pranë Universitetit të Arteve në klasën e profesorit Edison Miso. Nga 2013-2015 Cerri ndjek studimet e specializuara master në fushën e performancave muzikore pranë University of Agder, Norvegji Ai ka marrë pjesë në shumë masterklase të udhëhequra nga kitaristët më të shquar të kohës si : Petrit Ceku, Alvaro Pieri, Anders Miolin, Rolf Lislevand etj.

Cerri ka performuar në shumë koncerte brenda dhe jashtë vendit si solist, pjestar i ansambleve të muzikës së dhomës, pjestar i orkestrave të ndryshme, ku është shquar për aftësitë e tij teknike dhe muzikalitetin. Në 2016 ai ka performuar sëbashku me orkestrën e RTSH, ndërkohë që nga viti 2016 ai është lektor pranë Univeristetit të Arteve. Arber Cerri ka një aktivitet të pasur në jetën artistike koncertale vendase.

Caleidoscopio barocco

Musica strumentale fra Seicento e Settecento

COLLEGIUM PRO MUSICA

Stefano Bagliano
FLAUT DIRITTO

Fabiano Martignago
FLAUT DIRITTO

Angelica Selmo
KLAVICEMBAL



Ansambli Collegium Pro Musica themeluar në vitin 1990 dhe drejtuar nga flautisti Stefano Bagliano , është një formacion i specializuar në repertorin barok, të ekzekutuar sipas stilit të epokës duke përdorur instrumentët antik të kohës, me një organikë që varion nga trio deri në të ashtuquajturin formacion orkestral barok. Pjestarët e grupit gëzojnë një aktivitet koncertal në shkallë ndërkombëtare në bashkëpunim me muzikantë të shquar dhe formacione europiane të specializuara në muzikën antike. Collegium Pro Musica ka përformuar sëbashku me artistë si: Emma Kirkby, Gemma Bertagnolli dhe Roberta Invernizzi, violinisten Monica Huggett dhe klaviçembalistin Bob Van Asperen, të cilët kanë vlerësuar zgjedhjet muzikore dhe cilësinë e tingullit, ku shkëlqimi dhe ekspresiviteti italian janë kombinuar me rigorizitetin stilistik.

Collegium Pro Musica dhe Stefano Bagliano kanë performuar në festivale prestigjioze dhe evenimente muzikore në SHBA, Kanada, Japoni, Kinë, Izrael e në të gjithë Europën, në vende si *Gasteig në Mynih*, *Carnegie Hall* në New York, *Amici della Musica di Firenze*, *Società del Quartetto i Milanos*, *Musica e Poesia* në S. Maurizio, *Festivali Ndërkombëtar i Lubjanës*, në *Konservatorin e Pekinit*, *Ishibashi Memorial Hall* në Tokio, *Concerti di Radio RAI 3* në Palazzo Venezia, *Stagione del Gonfalone* e *Festival L'Orecchio di Giano* në Romë, *Istituti Italiani di Cultura* në Los Angeles të Marsejës, *Festivali i Jeruzalemit*, *Feste Musicali për S. Rocco* në Venezia, *Engadiner Konzertöchen*, *Boston Recorder Society*, *Teatro di Ekaterinburg*, *Steirische Kammermusik Festival* dhe *Adventkonzerten* në Graz, *Emilia Romagna Festival*, *Maggio della Musica* në Napoli, Festivale të ndryshme të muzikës antike në Valencia, Bolzano, Nizza, Avignon, Torino, Gorizia, Lago d'Orta, Trieste, Cagliari, Hyeres, Pescara, San Vito dei Normanni dhe festivale të tjera në Nancy, Bastaad, Middelburg, Aalborg, Genova, Briancon, Chateaufort du Pape, Beringen etc.

Njëkohësisht Collegium ka një aktivitet diskografik intensiv me disa prej shtëpive më të njohura si : Brilliant, Stradivarius, Dynamic, Nuova Era dhe Tactus - Sonate, Triosonate me të cilat ka regjistruar: Suitat dhe koncertet e Telemann, Koncertet për flaut, Koncertet e dhomës dhe Sonatat e Vivaldit, Koncertet dhe Sonatat e Sammartini, Koncertet e Fiorenza-s, Sonatat e B. Marcello, Sonatat e Merula-s, Kantatat e A. Scarlatti, Koncertet e Graupner dhe Graun, Sonatat e Stradella, Guerrieri e Bitti.

Programi:

Antonio Vivaldi (1678-1741)

Triosonata në sol minore RV 67 për dy flaute dhe b.c.
(grave-corrente-giga-gavotta)

Sonata në fa maxhor RV 46 për flaut dhe b.c.
(largo-allegro-largo-allegro)

Georg Philipp Telemann (1681-1767)

Duet në do minor për dy flaute
(vivace-moderato-allegro)

Jacob Van Eyck (1590 - 1657)

Variacioni mbi "...Daphne...." për flaut
"Engels nachtegaeltje" për flaut

Gerolamo Frescobaldi (1583 - 1643)

Toccata IX nga libri II nga Toccata për klaviçembal

Domenico Scarlatti (1685 - 1757)

Sonata në re maxhor K 96 "La caccia" për klaviçembal (Napoli 1537)

Georg Philipp Telemann (1681-1767)

Triosonata në fa maggiore TÈV 42:F7 për dy flaute e b.c.
(affettuoso-allegro-adagio-vivace)



**Raiffeisen
BANK**

**RAIFFESIEN BANK
NË HARMONI ME MAGJINË
E MË TË MËDHENJVE**

La canzone Napoletana...

Prima della canzone Napoletana

FESTA RUSTICA

Giorgio Matteoli
FLAUT DOLCE

Enrica Mari
KANTO

Massimiliano Faraci
KLAVICEMBAL

Matteo Scarpelli
VIOLONÇEL



Përmbajtja e origjinës së këngës napoletane? Tradita dëshmon për këtë përzierje të mrekullueshme të regjistrave shpeshherë të kombinuar me dritë dhe pasion, elementë këto të rrënjësuar fort në traditën popullore napolitane. Ngjashmëria me stilin meksikan të bolerove, muzika e rrugës, serenatat, kortezhi i këngëve të amalgamuara me jetën e përditshme ku ndërthuren klithmat e shitësve të rrugës mund të konsiderohen historikisht të pasakta. Elementët popullorë, dhe pse janë prezentë në këtë formë arti, i kanë rrënjët në romancat e salloneve të tetqindës si dhe nga tradita e melodramës. Kjo e fundit është e dëshmuar dhe nga fakti që kompozitorët e kësaj muzike ishin mjeshtra të krahasueshëm me Denza, Tosti dhe Donizetti. Lidhja me operën është tejet e rëndësishme: cantata barocca nuk është më pak se sa një opera në miniaturë. Nëse marrja gjithmonë e elementëve të gjuhës popullore napoletane ishte një burim i shfrytëzuar në ambjentin muzikor të kulturuar, nuk duhet të çudisë fakti që Alessandro Scarlatti, babai i shkollës operistike napoletane të shkruante në fillimet e shtatqindës një cantata të titulluar “Ammore, brutto figlio di pottana”. Ja pra që në periudhën baroke, gjeniu popullor përdorte “*Commedia in musica*”, shpeshherë i ngjashëm me “*Commedia dell’arte*”, ndërfutej si një virus në klasën e kulturuar dhe shkallat më të larta të fisnikërisë, gjuhë kjo e preferuar nga klasa borgjeze. Komedia e parë muzikore “La Cilla” e kompozitorit M. Faggioli, pati premierën e saj në 1706. Po kështu dhe struktura e cantatës “Lena” e Giulio Cesare Rubino, ashtu si dhe melodia e “*T’aggio voluto bene*” e Gaetano Latilla, mbajnë dy elemente të rëndësishme inspirimi: formën klasike dhe atë popullore. Kjo vihet re dhe në orkestrimin e parashikuar për arien e Latilla, ku një flaut risjell refrenet. Ekspresiviteti i jashtëzakonshëm i recitativeve dhe melodive të këtyre cantatave bëhet tanimë e përgjithmonë, karakteristika e një gjuhe muzikore që i flet ende sot zemrave tona me fjalë vërtet të “kuptueshme”. Kompletin programin një seri e “villanesche alla napoletana” apo arketipi i vërtetë i shijes popullore, frut i një kamuflimi

nga ana e kontrapunktistëve të zotë të këtij zhanri. Sot jemi të mësuar me ndarjen rigjide të zhanreve , por me siguri do na kish pëlqyer të shihnim një Mirna Doris apo Sergio Bruni të epokës të çimentohej në dialektin napoletan të një *cantate* të shkurtër baroke për të kaluar lehtësisht tek rolet operistike të Haendel apo në pjesën e një martiri në një oratorio *Hasse*.

Programi:

Giuseppe B. Porsile (1680-1750)

Cantata “Sfoggannose ‘no juorno”

Recitativo, Aria, Romanesca, Aria (da capo),

Recitativo, Aria

Giulio Cesare Rubino (XVII^osec.)

Cantata “Lena, mio si ca propeto”.

Recitativo, aria, recitativo, aria

Francesco Mancini (1672-1737)

Sonata VI in Sol maggiore per flauto e basso continuo.

Andante, Allegro, Largo, Allegro

Gaetano Latilla (1711-1788)

Aria: “T’aggio voluto bene”

Autore Anonimo

“Ianni dell’uorto”

dalla raccolta a stampa di Joh da Colonia
(Napoli 1537)

G.T. Di Maio (1548)

“Madonna nunn’e cchiù”

Valerio Dorico (?)

“La morte di marito”, dalla raccolta

“Madrigali a tre et arie napolitane”

Sbruffapappa O Gianleonardo

Dell’arpa (?)

“Vurria ca fusse ciaula”

e **“Vurria addeventare”**

Ensemble Festa Rustica

Con strumenti originali

Soprano, flauto dolce obbligato ,
clavicembalo, violoncello tiorba ad lib.

GIORGIO MATTEOLI

FLAUTO DOLCE

(Festa Rustica)



Giorgio Matteoli lindur në Romë në 1966 dhe është diplomuar për violonçel, *flauto dolce* dhe muzikë dhome pranë Konservatorit S. Cecilia në Romë e në të njëjtën kohë i diplomuar në letërsi dhe histori muzike pranë l'Università degli Studi në Romë. Ai ka ndjekur njëkohësisht studimet për kompozicion dhe kontrapunkt pranë Konservatorit të Como-s ndërkohë është formuar dhe si dirigjent pranë Konservatorit të Milanos me mjeshtër si D.Pavlov e P.Gelmini. Matteoli është specializuar në ekzekutimin e repertorit antik, si me flaut ashtu dhe me violonçel, duke bashkëpunuar me ansamble të njohur dhe institucione koncertale në Itali, Kroaci, Francë, Montecarlo, Spanjë, Shqipëri, Hungari, Ruman, Izrael dhe Japoni. Ai është autor i artikujve në fushën e muzikologjisë për revistat e specializuara në muzikën antike si Orfeo, CD Classic dhe Amadeus. Aktualisht është docent pranë Konservatorit dell'Aquila. Ka qënë solist (flauto dolce) për kolonën zanore të filmit La Bibbia me muzikë të M. Frisina dhe E. Morricone. Kjo e fundit është shpallur fituese e çmimit Oscar "Kable ACE". Në inçizimet e tij të shumta nisur me integralin e koncerteve për flaut dhe harqe të Mancini, përfshihen premiera absolute mes të cilave koncerti për flaut dhe harqe të N. Fiorenza (ASV-Gaudeamus) dhe materiale të zbuluara për herë të parë që i përkisnin kompozitorit F.A. Vallotti (Nove Lezioni per gli Uffici delle Tenebre), ku Matteoli ka mbajtur rolin e solistit violonçelist dhe njëkohësisht atë të dirigjentit. Ka drejtuar orkestra si "Nuova Cameristica", "Pomeriggi Musicali" dhe "Guido Cantelli" në Milano, l'"Orchestra Filarmonica Italiana", Korin dhe orkestrën "Q-Antica di Roma" ndërkohë në periudhën 2013-2014 ka drejtuar Orchestra dell'Associazione Mandolinistica Romana. Giorgio Matteoli është themelues i shoqatës Early Music Italia. Po kështu ai është ideator artistik i "Brianza Classica" e cila zhvillohet në Monza, Lecco dhe Milano. Themelues i Ansambllit barok "Festa Rustica". Nga 1992 Giorgio Matteoli themleu ansamblin barok Festa Rustica. Prej 20 vitesh ansambli është prezent në eventet më të rëndësishme koncertale italiane si Settembre Musica di Torino dhe Oratorio del Gonfalone Festival del Clavicembalo e Grande musica in Chiesa di Roma, Festival del Lago d'Orta si dhe festivalet ndërkombëtare në Francë, Spanjë, Montecarlo, Japoni, Ruman, Shqipëri. Ansambli gëzon një repertor të pasur ku një pjesë e konsiderueshme mban firmën e disa prej shtëpive diskografike më të njohura si AGORA, MUSICA IMMAGINE e GAUDEAMUS. Regjistrimi i fundit diskografik i ansambllit është ai i sonatave për *flauto dolce* dhe *basso continuo* të Haendel, publikuar nga MAP editions.

Stafi

Dejtues i Festivalit

JUSUF BESHIRI

Drejtor i Qendrës Vox Baroque

DENIZ BESHIRI

Drejtor Artistik

JUSUF BESHIRI

Koordinator i Përgjithshëm i Festivalit Vox Baroque

BESMIR VOKOPOLA

Kurator Imazhi

ELIDJON GREMBI

Dizajn Grafik

FLORIAN BREGU

Fotograf

ILIR ZAHAJ

